

Mendo Politikisht

ZGJEDHJE PARLAMENTARE
25 PRILL 2021



Hyrje

Mendo Politikisht është një nismë e ndërmarrë nga organizatat Aleanca LGBT dhe Pro-LGBT, që synon të inkurajojë komunitetin LGBTI të marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare të 25 Prillit 2021, duke i pajisur ata me informacion të detajuar mbi qëndrimet që partitë politike kanë mbi çështjet e këtij komuniteti.

Në raportimin e këtij viti zgjedhor, Mendo Politikisht është fokusuar jo vetëm te programet politike të partive dhe koalicioneve që garojnë më 25 Prill, por edhe te listat e kandidatëve të këtyre partive, të cilat me ndryshimet e rradhës së sistemit zgjedhor, janë bërë pjesë e garës elektorale, duke u dhënë mundësi qytetarëve që të votojnë specifikisht edhe për kandidatin apo kandidaten e tyre të parapëlqyer.

Mendo Politikisht është tashmë një program i konsoliduar i lëvizjes LGBTI në Shqipëri, nisur që në 2013, i cili paraqet problematikat e angazhimit politik të tyre, mos-përfaqësimin dhe mungesën e vëmendjes që klasa jonë politike ka ndaj këtij komuniteti.

Metodologjia

Ky monitorim është bazuar në mbledhjen e të dhënave përmes monitorimit të programeve të partive politike, monitorimit të mediave tradicionale dhe atyre online, kryerjes së sondazheve publike, si edhe nëpërmjet hulumtimit të fushatës elektorale që po kryhet nga partitë dhe koalicionet që marrin pjesë në këto zgjedhje parlamentare.

Programet politike janë aksesuar nëpërmjet faqeve zyrtare në internet të partive përkatëse, fushatave të tyre online dhe nga deklaratimet e tyre në media.

Partitë kryesore parlamentare janë kontaktuar disa herë nga Pro-LGBT dhe Aleanca LGBT, përmes letrave publike, postës elektronike dhe përmes kërkesave të dorëzuara dorazi në selitë e partive kryesore. Gjithashtu kemi publikuar një pyetësor me fokus perceptimet e minoriteteve mbi pjesëmarrjen në politikë, përmes platformës ECR të Historia Ime.

Monitorimi i mediave është kryer në periudhën parazgjedhore, por njëkohësisht kemi marrë në konsideratë dhe deklaratime apo qëndrime të politikanëve dhe kandidatëve gjatë viteve të shkuara për komunitetin LGBTI+ dhe të drejtat e tyre. Shoqërues i botimeve të mëparshme të Mendo Politikisht, ky raport synon për të ngritur debatin rreth çështjeve LGBTI+ në nivele më akademike.

Monitorimi i programeve

Kemi përzgjedhur disa parti, me të cilat vendosëm të nisnim një proces komunikimi, por edhe monitorimi, për përfaqsimin e tyre ndaj çështjeve LGBT.

Përzgjedhje u bë duke pasur parasysh disa kritere si për shembull përfaqësimi në parlament, parti të reja me pretendime dhe mundësi reale për t'u përfaqësuar në parlament, parti brenda koalicionit të djathtë, të përfaqësuar në qeveri në nivel zëvendës-ministrash si edhe parti kryesore në të dyja koalicionet.

Partitë e përzgjedhura janë: Partia Demokratike dhe koalicioni Aleanca për Ndryshim, Partia Socialiste, Lëvizja Socialiste për Integrim, Bindja Demokratike, Lëvizja për Ndryshim, Nisma Thurrje, Partia Social-Demokrate, si dhe Lëvizja Vetëvendosje, e cila garon me 3 kandidatë të pavarur në këto zgjedhje.

Fillimisht duhet thënë që një pjesë e mirë e partive politike nuk duket të kenë ende programe politike të mirëfillta, ato mjaftohen me një listë premtimesh pa sqarim të objektivave elektoralë dhe se si do të arrihen ato. Ajo që u vu re nga monitorimi i programeve të partive politike dhe që rezultoi ndryshe nga monitorimet e mëparshme, është se thuajse asnjë prej partive nuk përmendin **të drejtat e njeriut, sado përciptazi, ndërkohë që asnjë prej tyre nuk përfshin specifikisht çështjet LGBT** dhe as çështje që prekin komunitete të tjera vulnerabël.

Gjetje kryesore nga programet e partive politike

Vërejtja e parë gjatë procesit të monitorimit është kultura e mangët politike në Shqipëri, kur flasim për programet politike të partive kryesore që garojnë më 25 Prill dhe komunikimi jo-efektiv i këtyre programeve.

Nga monitorimi i kryer, vetëm tre parti kanë të publikuar programin e tyre të plotë në faqen e tyre zyrtare në web (LSI, Bindja Demokratike dhe Lëvizja Vetëvendosje), ndërsa partitë e tjera e kanë të komunikuar programin përmes deklaratave të kandidatëve për deputet në media, në takime elektorale apo edhe përmes faqeve të tyre në rrjete sociale.

Një tjetër element i rëndësishëm që mungon në këto programe dhe komunikimit të tyre për publikun është shpjegimi i mënyrës se si objektivat

e paraqitur pretendohen të realizohen.

Në një vështrim të përgjithshëm, nga 8 subjekte politike të monitoruara, asnjë prej tyre nuk ka një fokus të qartë të orientuar drejt të drejtave të njëriut apo promovimit të të drejtave të minoriteteve në shoqëri. Asnjë prej partive të monitoruara, nuk e përmend komunitetin LGBTI+ dhe as nuk garanton mbrojtje apo promovim të të drejtave të këtij komuniteti në programet e tyre.

Partitë kryesore të përfshira edhe në këtë monitorim, janë kontaktuar edhe zyratrisht nga organizatat LGBTI+ duke u pyetur specifikisht për çështjet e mëposhtme, por deri në javën e fundit të fushatës elektorale, asnjë prej partive nuk ka publikuar një qëndrim mbi çështjet në vijim:

- Ndryshimi i Kodit të Familjes duke njohur ligjërisht familjen si bashkim i dy qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, pa dallim gjinie.
- Konsiderimin e draft-ligjit “Për njohjen e identitetit gjinor” për diskutim dhe shqyrtim në Parlament dhe krijimin e kornizës së duhur ligjore për njohjen e mundësisë së personave transgjinorë/e dhe interseks për ndryshimin e gjinisë.
- Ndërhyrja në kurrikulat mësimore për t’i bërë ato më pranuese dhe gjithëpërfshirëse.
- Miratimi nga Këshilli i Ministrave i Planit Kombëtar të Veprimit për personat LGBTI+ në Shqipëri për periudhën 2021-2025.

4 pyetje, asnjë përgjigje!

Shqiptarët meritojnë procese transparente politike, mundësi zgjedhjeje dhe kandidatë e figura politike që nuk bëjnë dallime midis pjesës më të madhe të shoqërisë dhe minoriteteve.

Partia Socialiste

Partia Socialiste po garon e vetme më 25 Prill, duke synuar të qeverisë vendin për një mandat tjetër. Në faqen zyrtare të partisë në internet, programi nuk është i shpalosur dhe ky subjekt nuk i ka kthyer a përgjigje kërkesës sonë për informim. Programi elektorale prezantohet i fragmentarizuar në fjalime të kryetarit të partisë dhe përfaqësuesve kryesore politikë të PS.

Nga monitorimi i mediave, rezulton se fokusi i kësaj partie do të jetë ekonomia, rindërtimi dhe avancimi i mëtejshëm i reformave të ndërmarra gjatë dy mandateve të shkuara, por nuk përmendes specifikisht asnjë nga minoritetet në shoqëri dhe as komuniteti LGBTI+.

Programi i shpalosur në media në fusha specifike si drejtësia, arsimit, rimëkëmbja ekonomike, nuk përmend asnjë fushë me interes për kauzën e komunitetit LGBTI+ për barazi.

Partia Demokratike – Koalicioni Aleanca për Ndryshim

Partia Demokratike në këto zgjedhje udhëheq koalicionin Aleanca për Ndryshim i cili përbëhet nga disa parti. Edhe Partia Demokratike programin e saj elektorale nuk e ka të publikuar, por e komunikon përmes deklaratave për media dhe takimeve elektorale.

PD nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës sonë për informim. Kemi kontaktuar dhe parti të tjera të koalicionit (PR, PDIU, PBDNJ) të cilat gjithashtu nuk kanë kthyer përgjigje.

Nga monitorimi i deklaratave në media, rezulton se në programin e saj për Mirëqenien Sociale nuk përmendet fare komponenti i respektimit të të drejtave të njeriut apo të drejtave të komunitetit LGBTI+. Fokusi i koalicionit është gjithashtu ekonomia, politika e taksave dhe sipërmarrja. Njëkohësisht komuniteti LGBTI+ apo tema që mund të jenë me interes për to nuk përmenden as në pjesët e programit mbi Rininë apo Arsimin.

Në listën e tyre të qëndrimeve, PD përmend “Familjen” si “qeliza bazë dhe themelore e shoqërisë, e cila duhet të mbrohet si nga shteti ashtu edhe nga shoqëria.”, por pa pasur një përshkrim të qartë se çfarë nënkupton specifikisht ajo.

Lëvizja Socialiste për Integrim

Lëvizja Socialiste për Integrim ka një program të publikuar në faqen e saj zyrtare në internet. Kërkesës së organizatave për informin, nuk i janë përgjigjur.

Në listën e saj të prioriteteve zgjedhore, LSI përmend fusha si rritja e cilësisë së arsimit dhe mbështetja për gruan dhe familjen, por në asnjë pikë të programit nuk përmenden ndërhyrje specifike që do të mund të ndihmonin kauzën e komunitetit LGBTI+ për barazi.

Një gjejtje e rëndësishme është se kryetarja e kësaj Partie znj.Monika Kryemadhi, është në listën e kandidatëve të evidentuar prej nesh të cilët kanë përdorur gjuhë diskriminuese kundër komunitetit LGBTI+. Znj.Kryemadhi termin LGBT e ka përdorur në parlament si fyerje për kundërshtarët e saj politik dhe kauzën si të njëjtë me “vlera të imoralitetit e drogës.”.

Kandidatët e Lëvizjes Vetëvendosje

Lëvizja Vetëvendosje garon në këto zgjedhje me tre kandidatë të pavarur, respektivisht në qarqet e Tiranës, Gjirokastrës dhe Lezhës. Duke parë rrugëtimin e kësaj lëvizjeje në Kosovë edhe në programin me 5 pika për Shqipërinë përmenden gratë dhe barazia gjinore si një ndër fokuset e kësaj lëvizjeje. Ndër të tjera në programin e lëvizjes për këto zgjedhje, përmenden fusha si shëndeti, arsimi, inovacioni, por në asnjë pikë të programit nuk ka ndonjë përmendje për tema që i shërbejnë kauzës së komunitetit LGBTI+ për barazi.

Nisma Thurrje

Kjo lëvizje politike ka përdorur një qasje më inovative dhe të hapur ndaj qytetarëve duke propozuar 33 projektligje të shpjeguara me video dhe fushata mediatike në rrjete sociale. Ka mangësi në këtë drejtim pasi jo të gjithë kanë akses në internet dhe në rrjete sociale, sidomos kur flasim për individë nga grupet vulnerabël.

Në paketën e projektligjeve, përmenden tema si Barazia Sociale dhe Strehimi Social, ku ligjet aktuale synohet të përmirësohen në terma të implementimit për përfitimin nga shtresat e marginalizuara, por nuk ka informacion nëse përmendet ekzaktësisht komuniteti LGBTI+ ose jo.

Partia Bindja Demokratike

Partia Bindja Demokratike ka një program të publikuar në faqen e saj zyrtare në internet. Në programin e tyre zgjedhor, Bindja Demokratike në kapitullin mbi Rending dhe Sigurinë përmend se: “synon realizimin e një strategjie konkrete, bazuar në praktikat më të mira të policimit, mbi trajnimin dhe kualifikimin e të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit, që do të mundësojë kuptimin e qartë dhe respektimin rigoroz të drejtave të njeriut dhe zbatimin e ligjit.”, e cila mund të jetë me vlerë dhe për komunitetin LGBTI+, por pa dhënë detaje të mëtejshme apo pa përmendur grupe konkrete vulnerabël.

Partia Lëvizja për Ndryshim

Programi i Partisë Lëvizja për Ndryshim nuk gjendet i publikuar në rrjetet sociale apo online, por është i fragmentarizuar në postime dhe deklarata të kandidatëve të kësaj partie. Në asnjë prej tyre nuk është evidentuar ndonjë pikë që përfshin komunitetin LGBTI+.

Partia Social Demokratike

Programi i Partisë social demokrate gjendet i publikuar në rrjetet sociale, i fragmentarizuar në postime dhe deklarata të kandidatëve të kësaj partie. Në asnjë prej tyre nuk është evidentuar ndonjë pikë që përfshin komunitetin LGBTI+.

Më 25 Prill, Shqiptarët meritojnë figura politike që ngjallin shpresë, frymëzim dhe promovojnë frymën e gjithëpranimit.

Më 25 Prill, votoni për veten tuaj!

#MendoPolitikisht




MENDO POLITIKISHT


Perceptimet e komuniteteve të papërfaqësuar për fushatën zgjedhore

Përmes Engaged Citizens Reporting ECR, të integruar në Historia Ime, u përpoqëm të krijojmë një ide më të qartë mbi votuesit që vinë nga komunitetet e papërfaqësuar, mbi pikëpamjet e tyre në lidhje me politikën dhe fushatën aktuale zgjedhore. 55 ndjekës së faqes sonë, kryesisht të rinj nga komunitete të papërfaqësuar si (LGBTI+, Rom, Egjiptian, Persona me Aftësi të kufizuara) janë përgjigjur mbi perceptimet e tyre mbi politikën.

Mosha juaj?




A i përkisni ndonjë komuniteti pakicë? (Me komunitete pakicë nënkuptojmë: Rom, Egjiptian, LGBTI+, Pakica Kombëtare, Persona me Aftësi të Kufizuar)



Nga rezultati i pyetësorit vihet re një interesim i ulët i këtyre komuniteteve politikën, edhe pse të vetëdijshëm për impaktin që ajo ka në jetën e tyre të përditshme. Gjatë monitorimit mbi programet politike, rezulton se asnjë forcë politike nuk përmend komunitetin LGBTI+ për shkak të frikës së asociimit dhe humbjes së përkrahjes.

E njëjta gjë vërehet edhe te kandidatët, qofshin ato në listat e një force politike apo të pavarur. Por për komunitetet e papërfaqësuar, përfshirja e një kandidati LGBT+ në lista nuk do të ndikonte negativisht në perceptimin e tyre mbi partinë politike në fjalë, përkundrazi 3 në 4 persona do e mbështesnin këtë parti.


Nëse partia/kandidati që keni vendosur të votoni, do të mbështeste hapur komunitetin LGBTI+, a do e votonit sërish atë?



Elementet më të rëndësishme që ndikojnë në zgjedhjen e tyre politike janë platforma edhe programi politik si dhe vlerat që partia apo kandidati përfaqëson.

Të dyja këto elemente, nuk janë në plan të parë të punës së partive politike që garojnë në këto zgjedhje, pasi në pjesën më të madhe të tyre, partitë nuk kanë bërë tërësisht publike programet e tyre, të cilat janë të reduktuara në formë fjalimesh politike apo

postimesh në rrjete sociale, ndërkohë që vihet re dhe një apati dhe indiferencë nga to mbi promovimin e vlerave universale si të drejtat e njeriut apo barazia. Një gjetje tjetër e rëndësishme është se pjesa më e madhe deklarojnë se nuk ndikohen nga zgjedhjet e shoqërisë së tyre apo familjes.



Ata gjithashtu shprehin mos-interesim mbi proceset zgjedhore apo ngjarje të aktualitetit politik, pavarësisht se kuptojnë ndikimin e politikës në të përditshmen e tyre.



Ky publikim është pjesë e fushatës së advokimit “*Mendo Politikisht 2021*“, financuar nga Civil Rights Defenders dhe pjesë e projektit EUTH Advocacy. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë mënyrë si pasqyrim i mendimit zyrtar të Civil Rights Defenders.



Mendo Politikisht u realizua edhe në saj të mbështetjes së vazhdueshme të Bashkimit Evropian dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim AFD, përmes projektit “*Pride III/+ in Albania and Kosovo*”. Përmbajtja e tij nuk reflekton qëndrimet zyrtare të asnjë prej donatorëve.



This project is funded by the French Development Agency



This project is funded by the European Union



www.historiaime.al